

Krijimi i punësimit përmes promovimit të eksportit (CETEP)

Projekti promovon ofruesit e shërbimeve në sektorin publik dhe privat që punojnë në fushat e ekonomisë që janë të rëndësishme sa i përket punësimit dhe eksportit. Aktivitetet e projektit janë të orientuara drejt nevojave të kompanive nga sektori i teknologjisë dhe informacionit, prodhimit dhe bujqësisë (prodhimi dhe përpunimi).

GIZ-i dhe partnerët e saj u ofrojnë kompanive informata afariste që janë relevante për tregjet e BE-së, përfshirë këtu edhe informata mbi procedurat, rregulloret dhe certifikimet e produkteve në mënyrë që ata të mund të eksportojnë produktet në BE. Për më tepër, projekti përqendrohet në shërbime të orientuara në treg për zhvillim të korporatave, për shembull përmes fuqizimit të kapaciteteve organizative të asociacioneve apo përmes zhvillimit të modeleve të përmirësuara të biznesit për ofruesit e shërbimeve. Gjithashtu, projekti i mbështet kompanitë individuale në futjen e inovacionit në produkte apo procese që janë relevante për tregjet drejt të cilave eksportohet. Për më tepër, projekti i mundëson akterëve të sektorit publik dhe privat që të promovojnë eksportin e mallrave dhe shërbimeve.

Projekti shfrytëzon partneritetet ekzistuese me sektorin publik dhe privat të cilat janë krijuar në projektin e mëparshëm. Partnerët më të rëndësishëm bashkëpunues janë Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Odat Ekonomike dhe Asociacionet e Bizneseve. Në fushën e bujqësisë, Zyra Rajonale e GIZ ofron mbështetje sa i përket promovimit të eksportit. Ministria për Inovacion dhe Ndërmarrësi e Kosovës është duke bashkë-financuar projektin në fushën e inovacionit, mbështetjes së bizneseve fillestare (start-up)/NMVM si dhe promovimit të eksportit.